

## OSBE kritikon çrregullimet në zgjedhje

Ambasadori i OSBE-së Tiranë, Osmo Lipponen, tha se përsëritja e zgjedhjeve lokale në Himarë nuk shënoi asnjë progres. Përkundrazi ato ishin me të këqia se zgjedhjet e mbajtura më 12 tetor.

Në një intervistë për BBC-në, zoti Lipponen fillimisht i përgjigjet pyetjes se cilat ishin problemet kryesore që u paraqitën gjatë procesit të zgjedhjeve lokale në Shqipëri?

**Lipponen:** Një pjesë e procesit shkoi vërtetë mirë, por mund të themi se administrimi i zgjedhjeve dështoi dhe problemet më të mëdha ishin të lidhura me listat e votuesve. Gjithashtu kishte probleme edhe me punën praktike të komisioneve zgjedhore nëpër qendrat e votimeve. Prandaj mund të themi se administrimi praktik dështoi dhe si rezultat i kësaj kishte shumë paqartësi.

**BBC:** Zoti Lipponen, çfarë ndodhi më saktësisht sipas jush në zgjedhjet e së dielës në Himarë?

**Lipponen:** Unë jam njëqind përqind i sigurtë se zgjedhjet e përsëritura ishin edhe më keq se sa ato të 12 tetorit. Nuk ka nevojë të kthehemi përsëri në hollësi, sepse së pari duhet t'u japim shans autoriteteve të thonë ato që kanë për të thënë. Por ne kemi qenë dëshmitarë të të gjithë procesit, që nga vendosja e pikave të votimit deri në përcjelljen e kutive me vota. Ne kemi shënuar të gjitha që kanë ndodhur dhe nuk e shohim të arsyeshme të themi më shumë sesa “kanë ndodhur gjëra të turpshme”.

**BBC:** Zoti Lipponen, a mendoni se OSBE ka ndonjë përgjegjësi dhe se ka mundur të bëjë më shumë për mbarëvajtjen këtyre zgjedhjeve?

**Lipponen:** Ne kemi bërë aq sa kemi mundur të bëjmë. Ne arritëm të bëjmë mjaft. Ne u munduam të ndihmojmë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe ata kryen një punë mjaft të mirë. Ne arritëm edhe të trajnojmë median. Ne mbështetëm organizatat joqeveritare dhe i trajnuam ato për vëzhgimin e zgjedhjeve. Ne ndihmuam në sqarimin e rolit të policisë në mënyrë që ata të respektonin Kodin e ri zgjedhor dhe rolin që ai i cakton policisë. Mendoj se kemi bërë shumë, por megjithatë përkundër gjithë kësaj që bëmë zgjedhjet nuk shkuan siç duhet. Ne shtypëm kodin zgjedhor, rreth 30 mijë kopje, dhe e përkthyem në shqip, por nëqoftëse njerëzit që janë në kontroll të qendrave të votimeve dhe komisioneve zgjedhore nuk e lexojnë kodin zgjedhor dhe nuk denjojnë ta zbatojnë, është diçka që ne nuk mund të ndihmojmë kur jemi vetëm vëzhgues. Këtu përgjegjësia mbetet tek autoritetet shqiptare dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sepse OSBE vetëm mund të vëzhgojë dhe pastaj të dalë me raporte dhe të japë rekomandime si dhe masa me qëllim të përmirësimit të situatës, një gjë që ne tashmë kemi filluar ta bëjmë.